REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Durrës 02.07.2026

Lënda: Kthim përgjigje

”

Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", I ndryshuar, në përgjigje të kërkesës suaj ju informojmë si mëposhtë vijon:

Në përgjigje të kërkesës suaj për koment zyrtar lidhur me sallën “Black Box”, pranë shkollës artistike “Jan Kukuzeli”, Bashkia Durrës sqaron sa vijon:

Bashkia Durrës ushtron kompetencat e saj në përputhje me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe me Ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në zbatim të neneve 4, 8 dhe 9 të Ligjit nr. 139/2015, organet e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksionet e tyre në bazë të parimeve të autonomisë vendore, ligjshmërisë, transparencës dhe mbrojtjes së interesit publik. Në këtë kuadër, bashkia ka jo vetëm të drejtën, por edhe detyrimin ligjor të administrojë dhe mirëmbajë asetet publike që ndodhen në territorin e saj dhe në pronësi që shërbejnë për realizimin e funksioneve publike në fushën e arsimit, kulturës dhe jetës komunitare.

Neni 23 i këtij ligji ngarkon bashkitë me përgjegjësinë për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të institucioneve arsimore të sistemit parauniversitar, ndërsa neni 25 u njeh kompetenca të drejtpërdrejta në fushën e kulturës, përfshirë administrimin e infrastrukturës kulturore dhe organizimin e veprimtarive artistike në interes të komunitetit.

Gjithashtu, neni 28, pika 2 e Ligjit nr. 69/2012 përcakton se njësia bazë e vetëqeverisjes vendore ka përgjegjësi për garantimin e paprekshmërisë së institucioneve arsimore publike dhe mjediseve të tyre, si dhe për ruajtjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Kjo përgjegjësi nuk është vetëm formale, por përbën një detyrim të vazhdueshëm për të siguruar që asetet publike të jenë funksionale, të aksesueshme dhe të përdoren në përputhje me destinacionin e tyre.

Në këtë kuadër ligjor, Bashkia Durrës ka të drejtën dhe detyrimin të administrojë, mirëmbajë dhe garantojë funksionalitetin e infrastrukturës së shkollës artistike "Jan Kukuzeli", si dhe të ushtrojë akses institucional në ambientet që janë pjesë përbërëse e kësaj infrastrukture, përfshirë sallën "Black Box". Ky akses është i domosdoshëm për verifikimin e gjendjes së objektit, planifikimin dhe realizimin e ndërhyrjeve të mirëmbajtjes, garantimin e sigurisë së ambienteve dhe përdorimin e tyre në funksion të interesit publik. Me rikonstruksionin e godinës, shkolla është pajisur me ambiente bashkëkohore për zhvillimin e procesit mësimor dhe artistik, ndërsa salla "Black Box" është konceptuar si një hapësirë multifunksionale me funksion kulturor, edukativ dhe publik. Për vetë natyrën e saj, kjo sallë nuk përbën një ambient të destinuar ekskluzivisht për përdorim administrativ të një strukture të caktuar, por është projektuar për t'i shërbyer aktiviteteve artistike, projekteve kulturore, festivaleve, shfaqjeve, aktiviteteve edukative dhe nismave të tjera që kontribuojnë në zhvillimin kulturor të qytetit.

Për këtë arsye, Bashkia Durrës i është drejtuar zyrtarisht Drejtorisë së shkollës me kërkesë për vënien në dispozicion të çelësave të sallës "Black Box", me qëllim ushtrimin e përgjegjësive të saj ligjore mbi këtë aset publik. Kjo kërkesë nuk synon kufizimin e veprimtarisë së institucionit arsimor apo ndërhyrjen në procesin mësimor, por garantimin e administrimit të rregullt të një pasurie publike dhe mundësimin e përdorimit të saj në përputhje me funksionin për të cilin është ndërtuar. Administrimi i një pasurie publike nuk mund të kushtëzohet nga disponimi individual i çelësave apo nga kufizimi i aksesit ndaj autoritetit administrues. Një situatë e tillë do të krijonte pengesa në ushtrimin e kompetencave ligjore të Bashkisë Durrës dhe do të cenonte parimet e administrimit të mirë të pasurisë publike, të cilat kërkojnë kontroll, monitorim dhe përgjegjësi të vazhdueshme nga institucioni që ligji ngarkon me administrimin e saj.

Gjatë ndjekjes së kësaj procedure, Bashkia Durrës është përballur me refuzimin për vënien në dispozicion të çelësave të sallës "Black Box", duke krijuar një situatë të panevojshme

institucionale dhe mediatike. Megjithatë, Bashkia Durrës ka zgjedhur dhe do të vijojë të ndjekë ekskluzivisht rrugët institucionale, administrative dhe ligjore për zgjidhjen e kësaj çështjeje, në respekt të parimeve të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe të shtetit të së drejtës.

Bashkia Durrës mbetet e bindur se administrimi i pasurive publike duhet të realizohet në frymën e bashkëpunimit institucional dhe në funksion të interesit publik. Salla “Black Box” është një aset me rëndësi të veçantë për jetën artistike, kulturore dhe edukative të qytetit dhe si e tillë duhet të jetë funksionale, e mirëmbajtur dhe e aksesueshme për realizimin e misionit për të cilin është krijuar.

Në këtë kuptim, çdo veprim i ndërmarrë nga Bashkia Durrës ka për qëllim garantimin e përdorimit efikas të këtij aseti publik, ruajtjen e tij dhe vënien në shërbim të komunitetit artistik, nxënësve të shkollës “Jan Kukuzeli” dhe qytetarëve të Durrësit, në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë që legjislacioni në fuqi u njeh njësive të vetëqeverisjes vendore.